



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2019:143629

Datë: 12.10.2020

Numri i dokumentit: 01181372

C.nr. 01/19

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-Dega Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Burhan Berisha, duke vendosur në çështjen juridiko-civile të paditësit K.S. "I..." me seli në Prishtinë, Sheshi "Nënë Tereza" nr.33, kundër të paditurit B. R. nga Kaçaniku, për çështjen kontestuese rimbursim i dëmit, pas mbajtjes së seancës, më datën 15.07.2020, në praninë e të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të t'paditurit merr , ndërsa më datën 12.10.2020, përpilon me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET, në tërësi e bazuar, kërkesëpadia e paditëses K.S. "I..." me seli në Prishtinë, Sheshi "Nënë Tereza" nr.33.

II. DETYROHET i padituri B.Raka nga Kaçaniku, që paditëses të i'a paguaj shumën prej 845.00€ në emër të rimbursimit të dëmit, me kamatë ligjore, prej 8% duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive.

III. DETYROHET i padituri që të paguaj shumat si në pikën II. Të këtij dispozitivi si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 20€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Paditësja me datë 04.01.2019 ka parashtruar padi pran kësaj gjykate, kundër të paditurit lidhur me pagesën e borxhit në emër të rimbursimit duke theksuar se i padituri ka shkaktuar aksident trafiku me automjetin ..., me targa të regjistrimit, me rastin e shkaktimit të aksidentit i njejtë ka qenë nën ndikimin e alkoolit (3.41%) ndërsa në momentin e aksidentit automjeti ka qenë i siguruar me policë të sigurimit nr.0006151228 dhe me mbulesë siguroese për periudhën 13.03.2017 deri 13.03.2018, duke theksuar se i dëmtuari G. H. ka realizuar dëmin nga paditësja K.S."ILLYRIA"-Prishtinë në shumën prej 845.00€ sipas ujdisë

jashtëgjyqësore dat.13.10.2017, andaj i ka propozuar gjykatës që të miratohet në tërësi kërkespadia e paditësit si e bazuar pasi që i takon e drejta në rimbursim për shkak që shkaktari i aksidentit në momentin e aksidentit ka qenë nën ndikimin e alkoolit pa sigurim.

Shpenzimet i ka kërkuar për taksë gjyqësore.

Gjykata e ka njoftuarë të paditurin me obligimin për dhënjen e përgjigjes në padi po ashtu ka caktuar shqyrtim gjyqësor ndërsa i padituri e ka paraqitur përgjigjen në padi dhe e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar duke theksuar se në momentin e aksidentit vetura para meje ka frenuar në mënyrë të vrullshme dhe nuk kam mundur të ndalem, po ashtu ka theksuar se matja e nivelit të alkoolit në gjak sipas paisjeve të policisë së Kosovës nuk është bërë në mënyrën e duhur sepse paisjet e majtes janë të vjetra dhe mundësia e gabimit është e madhe, andaj ka theksuar se nuk e ndjen veten përgjegjës dhe si rrjedhojë nuk ndjen obligim për pagesën e borgjit, ndërsa në seancën pregaditore ku ka marrë pjesë i autorizuari i paditëses dhe i padituri personalisht ka deklaruar se qëndron pranë përgjigjes në padi ndërsa ka shprehur gatishmëri që qështjen ta përfundoj me ujdj gjyqësore, mirepo ka theksuar se ka nevojë të konsultimit me ndonjë avokat, për qka gjykata ka caktuar seancën kryesore të qështjes e duke i njoftuar palët prezent lidhur me seancën e radhës, ndaj të cilit njoftim palët nuk kanë pasur vërejtje, kurse në shqyrtimin gjyqësor i padituri nuk ka prezentuar në gjykatë edhe pse ishte i ftuar me rregull përmes procesverbalit të dt.16.06.2020, mungesën nuk e ka arsyetuar dhe as nuk ka kërkuar shtyerjen e shqyrtimit gjyqësorë, kurse gjykata konform nenit 423 par.4 të LPK-së dhe me propozimin e palës së paditur ka vazhduar shqyrtimin gjyqësorë në mungesë të palës së paditur.

Gjykata për ta vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë qështje juridike civile me propozimin e palëve e zhvilloi procedurën e provave duke e bërë leximin e këtyre provave të shkruara, u lexua: raporti i aksidentit i datës 22.07.2017, së bashku me deklaratën e dhënë në polici, konfirmimi i sigurimit nga KS "I." i datës 14.08.2017, pajtimi jashtëgjyqësor me numër të dëmit 1001-000549-002/17, konfirmimi i pagesës i datës 23.10.2017, vlerësimi i dëmit i datës 28.08.2017, procesverbali mbi dëmtimin e automjetit i datës 17.08.2017, librezja e automjetit e të dëmtuarit G.H dhe fotografit e automjetit të dëmtuar në 6 fletë, kërkesa për regresë, përgjigja në padi e të paditurit si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Ferizaj-Dega Kaçanik, Divizioni i Kundervajtjes me numër K.nr. 870/17, pa pyetje pa vërejtje.

Pas analizimit të provave në tërësi dhe të secilës veç e veç si dhe konform nenit 8 të LPK-së, dhe bindjes së lire të gjykatës, Gjykata lidhur me këtë qështje kontestimore juridiko civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

Ka ndodhur aksidenti i komunikacionit më dt 22.07.2017, në rrugën Ferizaj- Kaçanik , ky aksident është shkaktuar nga vozitësi i automjetit të udhëtarëve ..., me targa ..., të cilin e ngiste B.R nga Kaçaniku, në kohën e aksidentit ky automjet kishte mbulesë siguroese me afat të vleshmërisë ndërsa në momentin e aksidentit vozitësi (B.R) ishte duke drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit (3.41%), nga kjo është shkaktuar dëm palës së dëmtuar (G. H.) e cila e

ka realizuar kërkesën pasurore juridike në lartësi prej 845.00€, e që sipas ligjeve në fuqi është përgjegjës për rimbursimin e dëmeve të shkaktuara në këtë formë.

a) Se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më 22.07.2017 rreth orës 02:50 min. Në rrugën Ferizaj-Kaçanik, i shkaktuar nga automjeti ... “ me targ ..., vozitësi i të cilit ishte B.R tani i paditur, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga Raporti i aksidentit i datës 22.07.2017, si dhe nga Aktgjykimi i GJTHF-Dega Kaçanik Nr.K 870/17 i datës 03.05.2018, i plotfuqishëm më datën 04.06.2018. me të cilën i pandehuri B.R është shpallur përgjegjës për aksidentin e datës 22.07.2017.

b) Se në ditën e aksidentit i padituri ka drejtuar automjetin e tij nën ndikimin e alkoolit këtë fakt gjykata e vërtetoi nga raporti i aksidentit i .07.2017, si dhe nga Aktgjykimi i GJTHF-Dega Kaçanik Nr.K 870/17 i datës 03.05.2018 ku vërtetohet se në momentin e aksidentit i padituri jo vetëm që ka qenë shkaktar i aksidentit por edhe ka qenë duke drejtuar automjetin pa nën ndikimin e alkoolit(3.41%), këtë fakt po ashtu e dëshmojnë edhe provat tjera të paraqitura me anë të padisë me të cilën shihet procedura e tërësishme e paditësit me rastin e mbulimit të dëmit palës së dëmtuar dhe po ashtu ky fakt nuk ishte kontestues, pala e paditur me anë të përgjigjes në padi nuk e ka mohuar faktin se automjetin e ka drejtuar nën ndikimin e alkoolit, mirepo ka pasur dyshime lidhur me lartësinë e nivelit të alkoolit në gjak, e për të cilin fakt nuk ka arritur ta dëshmojë me asnjë provë konkrete.

c) Se i dëmtuari G. H. e ka realizuar dëmit në procedurë jashtëgjyqësore nga pala paditëse këtë fakt gjykata e vërtetoi nga ujdia jashtëgjyqësore 13.10.2017, Urdhërtransferi për pagesë të datës 23.10.2017, procesverbali mbi dëmtimin e automjetit dt.17.08.2017 e të cilat prova ishin të mjaftueshme për gjykatën dhe njëherit nuk u kontestuan nga palët ndërgjyqëse, kjo nga faktin se pala e paditur edhe pse ka qenë i njoftuar për mundësinë mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë, ka qenë i informuar mbi të drejtën e paraqitjes së provave për të dëshmuar pretendimet e tija, i njejt i nuk ka prezentuar në gjykatë në seancën kryesore e që rrjedhimisht e ka lëshuar mundësinë për të kundërshtuar apo mohuar faktet e ndryshme të paraqitura nga pala paditëse, në të kundërtën gjykata faktet e tilla i konsideron si fakte të pa kontestueshme për rrjedhën e procedurës, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata si dispozita materiale në këtë qështje juridike aplikoi nenin 14 par.1.3 dhe par.3 të Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Ligji nr 04/L-018 si dhe nenit 281 të LMD-së.

Mbi bazën e kësaj gjendje të vërtetuar faktike e cila u vërtetua në mënyrë të plotë dhe të drejtë që rezultoi nga të gjitha provat e nxjerrura dhe të vlerësuara, gjykata vlerëson se janë eliminuar të gjitha faktet kontestuese për vendimmarrje dhe kërkesë padinë e paditësit e miratoi në tërësi si të bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqenëse i padituri ka rënë në vonesë me kompensimin e dëmit –rimbursimit Gjykata me kërkesën e paditëses dhe në bazë të nen.382 të LMD-së, e detyroi të paditurin që paditëses në shumat e gjykuara t’ia paguaj edhe kamatën prej 8% pasi që me Ligjin mbi marrëdhëniet e

Detyrimeve është paraparë se Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën dhe se lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj, nga momenti i vërtetimit të plotë të gjendjes faktike e deri në pagesën definitive.

Gjykata e detyroi palën e paditur që paditësit të ja paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 20€ në emër të taksës për padi, të parapara sipas udhëzimit administrativ nr.01/2017 të Këshillit Gjyqësorë të Kosovës, gjykata vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.1,453 dhe 449 të LPK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK
C.nr.01/19 date 12.10.2020

Gjyqtari:
Burhan BERISHA

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit të Kosovës përmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.